



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL-1001, Tiranë - SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 222 260

Nr. ⁴⁹⁶⁷ Prot.

Tiranë, më 23.07.2010

URDHËR

Nr. 386, datë 23.07.2010

PËR

AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, DIPLOMË E NIVELIT TË DYTË (DND) NË "DREJTËSI" DHE MASTER I NIVELIT TË DYTË NË "SHKENCA JURIDIKO - PENALE" TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "JUSTINIANI I"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

URDHËROJ :

1. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) në "Drejtësi" të Instiucionit të Arsimit të Lartë "Justiniani I" në përputhje me vendimin nr. 85 datë 18.06.2010 të Këshillit të Akreditimit.
2. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të tretë, Master i Nivelit të Dytë (MND) në "Shkenca Juridiko - Penale", të Instiucionit të Arsimit të Lartë "Justiniani I" në përputhje me vendimin nr. 85 datë 18.06.2010 të Këshillit të Akreditimit.
3. Instiucioni të Arsimit të Lartë Privat "Justiniani I" bazuar në vendimin nr. 85 datë 18.06.2010 të Këshillit të Akreditimit, nga dalja e këtij urdhri, të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin e Këshillit të Akreditimit, bashkalidhur këtij urdhri.
4. Instiucioni i Arsimit të Lartë Privat "Justiniani I" do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 i ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë"
5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe Shkolla e lartë universitare private "Justiniani I".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAFAJ

MINISTËR



Urdhër për akreditim



ministra e arsimit dhe shkencës
ministra e së nesërmes
www.mash.gov.al